



TE 7
Berat BUZHALA
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2018/20
Ref:1807/799/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2018/20 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për TE 7 (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 23 mars 2018 ka pranuar një ankesë nga znj. Shqipe Pantina ndaj kronikës “Afera e Topallit me Pantinën”, të transmetuar me datën 18 mars 2018 në edicionin e lajmeve të orës 19:30 të Palës Përgjegjëse, përmes së cilës znj. Pantina pretendon se Pala Përgjegjëse përmes kësaj kronike ka bërë: *“shkelje flagrante të të drejtave individuale të sanksionuara me nenin 7 të Kodit Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Konkretisht, kronika shkel nenin 7 pikën 1... Ndërhyrje në çështjet thjesht private dhe personale; pikën 4 transmetim i bisedave telefonike pa njoftim paraprak; pikën 5 sulm në ndershmërinë, integritetin apo cilësinë personale të një personi. Përveç kësaj një kronikë e tillë është në shkelje të Ligjit nr. 02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.”*
3. KPM me datën 23 mars 2018 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga znj. Pantina dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM me datën 28 mars 2018 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës e ka kundërshtuar pretendimin e ankesës, duke theksuar se publikimi i kronikës në fjalë ishte me interes për publikun dhe është bërë në mirëbesim, duke u bazuar në të dhënat e besueshme nga burimet e televizionit.

5. KPM ka analizuar ankesën e znj. Pantina, përgjigjen e Palës Përgjegjëse dhe ka bërë monitorimin e emisionit ndaj të cilit është bërë ankesa më qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

Analiza Ligjore

6. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 7 Të drejtat individuale, paragrafi 1, 4 dhe 5 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

KPM pretendimet e Palës ankuese i ka trajtuar në bazë të neneve të cekura në ankesë, në kuptimin e nenit 7 paragrafi 1, 4 dhe 5 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03. Në lidhje me këtë çështje neni 7, paragrafi 1 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“E drejta e privatësisë së individëve duhet të respektohet. Ndërhyrja në çështjet thjeshtë private apo personale të cilat nuk kanë ndikim në interesin publik është e ndaluar. Ata që janë prekur nga tragjedia apo pikëllimi duhet të trajtohen me ndjeshmëri, respekt dhe maturi duke e respektuar privatësinë e plotë të tyre.”

Nga analiza që i është bërë përmbajtjes së transmetuar nga Pala Përgjegjëse vërehet se informatat e plasura te publiku janë thjeshtë të natyrës private dhe personale të personave të apostrofuar në kronikën e transmetuar, dhe se interesi i publikut për të ditur në lidhje me jetën private të palës ankuese nuk është as i predispozuar dhe fare nuk nxitë debat me interes publik.

Çështjet të cilat konsiderohen Interes Publik janë të përcaktuara qartë në dispozitat e Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes dhe me standardet ndërkombëtare të transmetimit dhe se pretendimi i Palës Përgjegjëse se informatat e transmetuara përbëjnë interes publik rezulton të jetë i pabazë.

Përmbajtja e kronikës së transmetuar në asnjë aspekt nuk trajton çështjen e ushtrimit të përgjegjësisë institucionale dhe ligjore nga ana e deputeteve të zgjedhur, fakt ky i cili do të përbënte interes publik dhe do të nxiste debat publik. Përmbajtja e kronikës së transmetuar elaburon thjeshtë një raport privat dhe personal të supozuar të deputetëve dhe është jashtë domenit të interesit publik, dhe si e tillë paraqet sulm personal dhe bie ndesh me nenin 7, paragrafi 5 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Sulmet personale, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në sulmet në ndershmërinë, integritetin apo cilësinë personale të një personi, institucioni apo grupi të identifikuar, në çështje që nuk kanë të bëjnë me interesin publik, janë të ndaluara.”

7. Komisioni i KPM-së gjithashtu nga të gjeturat e monitorimit gjen se janë transmetuar biseda telefonike të palës ankuese pa e njoftuar palën ankuese paraprakisht, veprim ky i cili bie ndesh me neni 7, paragrafi 4 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

"Bisedat ose intervistat telefonike nuk duhet të transmetohen pa e njoftuar palën tjetër paraprakisht, përveç kur është fjala për interesin publik."

8. Komisioni i KPM-së duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7 Të drejtat individuale, paragrafi 1, 4 dhe 5 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendimi

9. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura kërkon nga Pala Përgjegjëse që në afat prej pesë (5) ditësh nëpërmes transmetimit t'i kërkojë falje znj. Shqipe Pantina, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 1.2 të Ligjit të KPM-së;
10. Komisioni i KPM-së bazuar në nenin 30, paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, merr vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në vlerën prej 2,000 (dymijë) euro, për shkelje të nenit 7 Të drejtat individuale, paragrafi 1, 4 dhe 5 të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

11. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
12. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Muja FERATI
Kryetar



10.07.2018
Datë